



FIF - Go Digital in WB - Union Bank

Vendi:	SHQIPËRI
Numri i projektit:	55881
Sektori i biznesit:	Kredi depozitore (bankat)
Lloji i njoftimit:	PRIVAT
Kategoria mjedisore:	FI
Data e synuar e miratimit:	26 Nëntor 2024
Statusi:	Miratuar
PSD njoftuar më:	6 Dhjetor 2024

Përshkrimi i projektit

Dhënia e një kredie të pasiguruar deri në 3.0 milionë euro për t'u vënë në dispozicion në tre këste në kuadër të programit të BERZH-it 'Go Digital in WB'. Këstet e dyta dhe të treta do të jenë të paangazhuara.

Objektivat e projektit

Të ardhurat nga investimet e Bankës do të përdoren për të ofruar financim të specializuar që do të mbështesë automatizimin, digjitalizimin, përmirësimin e konkurrencës dhe promovimin e teknologjive të gjelbra për NVM-të që përmbushin kriteret e Deklaratës së Politikës përkatëse. Të paktën 60% e investimeve totale do të jenë për projekte të automatizimit dhe digjitalizimit që përmbushin kriteret e pranimi, nga të cilat të paktën 60% duhet të përmbushin kriteret GET. Për më tepër, të paktën 60% e investimeve totale duhet të përmbushin kriteret GET.

Ndikimi i tranzicionit

ETI 65

Projekti kontribuon në objektivat e FIF, duke mbështetur cilësitë e Ndikimit në Tranzicion të **Konkurrencës dhe Qëndrueshmërisë mjedisore**:

Konkurrenca: Projekti do të inkurajojë konkurrencën e NVM-ve duke zgjeruar huadhënien digjitale për NVM-të në përputhje me standardet e FIF.

Qëndrueshmëria mjedisore: Projekti do të kontribuojë në cilësinë e TI-së së qëndrueshmërisë mjedisore duke adresuar eficiencën e energjisë si pjesë e aktiviteteve që përmbushin kriteret për investime të NVM-ve.

Informacion në lidhje me klientin

UNION BANK SHA

Union Bank ShA ("UB") është një bankë e mesme në Shqipëri, e fokusuar kryesisht në kreditimin e SME-ve dhe individëve. Që nga fundi i vitit 2024, UB-ja është banka e 8-të më e madhe në vend (nga 11) për sa i përket aseteve dhe portofolit të kredisë, me përkatësisht 5.1% dhe 6.4% të tregut.

Përmbledhja e financave të BERZH-it

3.000.000,00 euro

Kostoja e përgjithshme e projektit

3.000.000,00 euro

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Ky Program do të kategorizohet si FI (ESP 2019). Union Bank është një klient ekzistues i Bankës dhe performanca mjedisore dhe sociale nën ekspozimet ekzistuese kanë qenë të kënaqshme. UB duhet të mbajë një sistem menaxhimi mjedior dhe social që të vlerësojë, menaxhojë dhe monitorojë risqet mjedisore dhe sociale dhe impaktin tek nën projektet që financon. UB duhet të përmbushë Kriteret e Performancës së BERZH 2, 4 dhe 9 përfshirë listën e përjashtimeve Mjedisore dhe Sociale të BERZH dhe listën Referente të prezantuar me Politikën Mjedisore dhe Sociale 2019, të vazhdojë të implementojë udhëzimin për Menaxhimin e Riskut Mjedisor dhe të përgatisë Raporte Vjetore Mjedisore dhe Sociale për Bankën. Huamarrësit e financuar nga huaja e UB do të duhet të përmbushin detyrimet mjedisore, sociale, të sigurisë dhe shëndetit në punë sipas ligjeve lokale në fuqi.

Nëse financimi i BERZH do të përdoret për financimin e projekteve të energjisë diellore këto projekte do të menaxhohen në përputhje me "Qasjen e Propozuar për Menaxhimin e Riskut të Zinxhirit të Furnizimit të Energjisë Diellore" (CS/FO/21-35) dhe çdo udhëzim që zhvillohet nën këtë qasje.

Bashkëpunimi Teknik

TC: TC përfshin mbështetjen e NVM-ve nga Konsulenti i Programit për përgatitjen e planeve për investime të financueshme dhe për të mbështetur PFI-të në zhvillimin e një portofoli të nën-investimeve të pranueshme, si dhe asistimin me zbatimin, monitorimin dhe verifikimin e zbatimit teknik dhe përputhshmërisë së investimeve përpara se të lëshohen pagesat nxitëse për NVM-të përkatëse. Gjinia është integruar në nivelin e programit me fokus specifik në NVM-të e drejtuara nga gratë, me trajnime për të shtuar konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e operacioneve të biznesit të

përfituesve përfundimtarë.

Plotësueshmëria

Për më tepër, ky projekt përfshin ofrimin e financimeve afatmesme me periudhë të gjatë maturimi, të cilat nuk janë të disponueshme në tregun e financuar nga depozitat afatshkurtra, si dhe ekspertizën në automatizimin, digjitalizimin dhe huadhënien për qëndrueshmërië mjedisore.

Bashkëpunimi teknik do të mundësojë ngritjen e kapaciteteve të brendshëm të UB-së për të shtuar përpjekjet për kursimin e energjisë nëpërmjet teknologjisë digjitale, në përputhje me kërkesat mjedisore dhe sociale (E&S), ndërkohë që 60% e nënhuave pritet të përmbushin standardet GET.

Komponenti Gender SMART promovon aksesin e barabartë në financa për NVM-të e drejtuara nga gratë, me trajnime të specializuara për të përmirësuar gatishmërinë për digjitalizim, interesimin ndaj projekteve dhe strategjitë e përgjegjshme gjinore.

Informacioni i kontaktit për shoqërinë

Emila Vucini

emila.vucini@unionbank.al

+355 4 238 8097

www.unionbank.al

Bulevardi Zogu i I, Sheshi Ferenc Nopçka, Nd. 5, H. 3, Njësia Bashkiake Nr. 9, Kodi Postar 1016, Tirana, Albania

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt. OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH. Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bëres publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH . MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikën e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur

problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.